



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. prot 20570

Tiranë 1/7/2016

NJOFTIM

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ditën e **mërkurë, datë 06.07.2016, ora 17.00**, në sallën e Këshillit Bashkiak, me rendin e ditës si vijon:

1. P/Vendim: Për “**Trajtimin me Bonus Strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë**”.
2. P/Vendim: Për “**Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, Ish-Fonderia Mek**”
3. P/Vendim: Për “**Ngritjen e Task Force-s për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë**”.
4. P/Vendim: Për “**Miratimin e Rregullores për zënien e hapësirave publike në Bashkinë e Tiranës dhe strukturave përgjegjëse për zbatimin e saj**”.
5. P/Vendim: Për “**Miratimin e dhënies së ambjentit në përdorim Organizatës Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve-ARSIS, për një periudhë një vjecare, me destinacion për qendër sociale, në zbatim të Projektit “Ngritja e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhenca, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, nëpërmjet vënies në punë të qendrës multidisiplinare në Njësinë Administrative nr.7**”.
6. P/Vendim: Për “**Krijimin e Qendrës TEN**” si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”
7. P/Vendim: “**Për miratimin dhe zbatimin e Projektit “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”, hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për Zbatimin e Projektit “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”, në bashkëpunim me UN Women Albania**”.
8. P/Vendim: “**Për delegimin e funksionit të mirëmbajtjes së varrezave, Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale, Tiranë**”.
9. P/Vendim: “**Për miratimin në parim të dhënies me qira të objektit truall me sipërfaqe totale 10521.56 m2 në rrugën “Hamdi Pepa”, Njësia Administrative Nr. 6**”.

10. P/Vendim: Për “Miratimin në parim të dhënies me enfiteozë të objektit “Reparti i Galanterisë” me sipërfaqe totale 2766.5 m2, njësi e Ndërmarjes Metalike Tirana”.
11. P/Vendim: Për “Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016 (i ndryshuar)”.
12. P/Vendim: “Për disa ndryshime në VKB Nr. 59 datë 30.12.2015 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës” i ndryshuar ”.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **Komisioni Juridik:**
Eridian Salianji (Kryetar), Fabian Topollari (zv/kryetar), Klotilda Bushka, Blerina Doracaj, Agim Kraja, Kreshnik Çollaku, Akil Kraja.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe do të mblidhet ditën e hënë, datë **04.07.2016, ora 16:00.**
- **Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes:**
Kozeta Fino (Kryetar), Mateo Spaho (zv/kryetar), Aida Llazani, Elisa Spiropali, Ardit Çela, Suzana Guxholli, Reila Bozdo, Vjollca Braho.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 4, 5, 7, 8, 9, 10 dhe do të mblidhet ditën e hënë, datë **04.07.2016, ora 18:00.**
- **Komisioni i Shërbimeve Publike;**
Akil Kraja (kryetar), Luan Bregasi (zv/kryetar), Auran Xhani, Ira Vejsiu, Eriona Bixha, Ariana Çela, Kreuza Leka.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 3, 4, 8 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **06.07.2016, ora 11:00.**
- **Komisioni për Barazinë Gjinore dhe sipërmarrjen e Gruas;**
Alketa Hila (kryetar), Merita Poni (zv/kryetare), Klotilda Bushka, Bora Panajoti, Erisa Xhixho, Reila Bozdo, Ariana Çela
Komisioni do të shqyrtojë pikën 5 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **06.07.2016, ora 12:00.**
- **Komisioni i Strehimit dhe Çështjeve Sociale;**
Klotilda Bushka (kryetar), Merita Poni (zv/kryetar), Florian Pullazi, Endrit Brahimllari, Albina Nanaj, Besnik Aliaj, Ferdinand Shehu.
Komisioni do të shqyrtojë pikat 1, 2 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **06.07.2016, ora 13:00.**

KRYETAR
ALDRIN DALIPI

